

Prill - Maj 2015

Botim i Qendrës, Agjencia AJMMI (Agjencia Joniane e Mjedisit, Medias dhe Informacionit)

Nr. 010



Pranvera  
FOTO (SH.H-AJMMI)

*Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC në kuadër të programit SENiOR-A-“Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri”. Ky program është -financuar nga Qeveria Suedeze”*

## “Urat e Mjedisit”

është botim periodik i Qendrës “AJMMI” (Agjencia Joniane e Mjedisit, Medias dhe Informacionit). Në këtë revistë do të gjeni informacione dhe opinione mbi problematikat mjedisore kryesisht në jug të Shqipërisë si dhe çështje të lidhura me zhvillimin e mediave dhe trajnimin e gazetarëve në një rajon multikrahinor e multi-etnik.

është organizatë joqeveritare, A.JMMI jofitimprurëse e jopolitike, e përbërë nga specialistë me përvojë të mjedisit dhe medias që operon në fushat respektive të mjedisit dhe medias, përgjithësisht në rajonin Jonian, në jugun e Shqipërisë e me gjerë. Agjencia “AJMMI” është krijuar në vitin 2007.

**VIZIONI i Agjencisë “AJMMI: “Miqësor ndaj Mjedisit dhe një Media me fytyrë publike”**

### STAFI BOTUES

EDITOR: Shkëlqim HAJNO

### REDAKSIA:

Kryeredaktor: Dr Agim NELAJ  
Panajot BOLI, Blerim KORE  
Aferdita SELIMAJ, Xhorxhi VASILI

### KONSULENTË:

Për mediat:  
Arben Muka- DW, Tiranë  
Ing.Kristo Kauri

### ADRESA:

Agjencia “AJMMI”/Rr.”A.Çuni”,  
Nr.35.L.Nr.4, Sarandë/  
Tel/fax: 0852 25678 / 06922 35 026/  
0692708020

agency\_ajmmi@yahoo.com  
/ www.ajmmi.com

**NR. I LLOGARISE**  
**SOCIETE GENERALE ALBANIA**  
0001177415

**IBAN:**  
AL 9221363010000000001177415

### Qendra AJMMI OJF


Mbështetur nga REC Shqipëri

## NGA BRENDIA

### VIZION: Vizioni im për zhvillimin e gjelbër të Bashkise

Motoja jone eshte Saranda blu dhe e gjelbert. Krijimi i hapsirave te reja publike, zgjerimi i lulishteve, gjelberimi masiv duke filluar nga taracat e pallateve. Krijimi i brezit te gjelbert qe eshte nje nga pikat kryesore te programit, do te rrethoje gjithë zonat e urbanizuara te Bashkise Sarande.

Nga Kreshnik BOZHO



3

### FOKUS: Turizmi familjar, mundësi që duhet shfrytëzuar!

Turizmi familjar po shnderrohet ne nje prej formave me te pelqyera per disa kategori turistesh qe perbejne nje numer te madh ne teresi. Ne shume vende te botes eshte investuar ne kete drejtim dhe tashme turizmi familjar perfaqeson burimin kryesor te punesimit dhe te te ardhurave per teresine e familjeve qe e praktikojne.

Nga Mirjan TOPI



11

### PORTRET: Gjirokastër: Kanan Zano, emblemë e humanizmit

Lavdia është një peshë e rëndë, një helm vdekjeprurës: ta durosh është një art. Portreti i Kanan Zanajt të bën të kujtosh të shkuarën, të bën të vendosësh mbi këmbë të forta profesionin e infermierit, nga i cili ke seç të përfitosh.

Nga Mimoza Llavdaniti



6

### FEJTON: Premtimet elektorale dhe... leshtë!

Nga Ana Gjon LEKDUSHI

14

### INTERAKTIV: Bashkepunim me qytetaret dhe ekspertet.

Nga te gjithë treguesit Tirana eshte nje nder 5 qytetet me te ndotur te Evropes” - tha Xhemal Mato.

Nga Alisa PEÇI



5

### QASJE: Të pastrojmë bregdetin në një ditë

Një globalist i shquar, në një samit ndërkombëtar, tha: “ndotja e mjedisit është thjesht pas efekt i ndotjes së shpirtit”. Njeriu duhet të jetë i ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka mjedisi, për respektin që meriton, si dhe për kujdesin që duhet të rritet vazhdimisht.

Nga Mcs Vasilika KREKU



13

### MUZAT ESSE

Të mëshironi nje komb qe mirëpret qeveritarin e ri me brohoritje dhe e percjell ate me klithma perçmimi deri sa te pres te riun me brohoritje nga e para.

Nga Khalil GIBRAN



15

Shtypur në shtypshkronjën “Argjiro”, Gjirokastër  
Art Desing:  
Alda Muho

Mbështetur nga:



në kuadër të programit

**SENIOR-A** Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri

# Vizioni im për zhvillimin e gjelbër te Bashkise

- Kandidati KRESHNIK BOZHO ( i aleance se djathte) per zhvillimin e gjelbër te Bashkisë Sarandë -



**Pyetje 1: Cili është vizioni juaj për një zhvillim të gjelbër në Bashkinë e re të Sarandës?**

-Zhvillimi mjedisor është një nga pikat më të rëndësishme për çdo bashki, dhe sidomos për specifikat e Bashkisë Sarandë, si një prej atraksioneve kryesore turistike në vend. Për të rritur vlerat e bashkisë sonë turistike dhe cilësinë e jetës së banorëve, ne do të ndërmarrim një sërë nismash për përmirësimin e cilësisë mjedisore nëpërmjet rritjes së hapësirave të gjelbra të cilat do të shtohen përmes:

Krijimit të lulishteve të reja në qytet nga rikualifikimet urbane; Gjelbërimit të mjaftueshëm brenda blloqeve të banimit me lulishte ose këndeve të gjelbëruara duke dhuruar fidan për çdo komunitet apo bllok banimi që dëshiron të kthej sheshet mes pallateve në zona të gjelbëruara; Gjelbërimit të taracave dhe fasadave të ndërtesave; Gjelbërimit me pemë dhe shkurre dekorative përgjatë rrugëve dhe trotuarëve, si dhe ngritjen e barrierave të dendura

me gjelbërim sipër dhe që ndan trotuarin nga rruga;

Krijimit të fushatave promovuese si:

- “Mbill pemën tënde”! – Çdo bebe që lind, bashkia do t’ju dhurojë prindërve fidan që t’i mbjellin për mbarësi;

- “Pylli i personave” – kush dëshiron të paguajë që të mbillet një pemë me emrin e tij;

- “Community Gardens” – bashkia jep sipërfaqe të vogla (40 m2) për qytetarët që duan të krijojnë kopshte me lule ose erëza.

**Pyetje 2: Cilat janë problematikat me të mprehta mjedisore në tokë dhe në det te cilat i keni konstatuar si do t’i zgjidhni ju?**

-Derdhja e ujrave te zeza ne det është kthyer ne nje shqetesim te vazhdueshem per turistet dhe banoret. Impjanti i Filtrimit te Ujrave te Zeza, nje ivestim me shume vlere i qeverisjes demokratike është tashme ne funksion. Studimi i mundesive per permiresimin e teknologjise impiantit te pastrimit te ujrave

te perdorura per perballimin e situates gjate sezonit turistik do te jete prioritete. Permiresimi i Teknologjise se Impiantit te trajtimit te ujrave te zeza dhe shtimi i lidhjeve te ndertesave me rjetin e kanalizimeve per te eliminuar gropat septike, do te sjellin nje permiresim te dukshem ne cilesine e ujit te detit

Nje pike tjeter e nxehte është edhe keqmenaxhimi i mbetjeve urbane. Landfield-i i Bajkajt është nje veper me shume rendesi ne ndihme te menaxhimit te mbetjeve dhe zhvillimit te drejte mjedisor per Bashkinë Sarandë. Duke bere nje studim serioz dhe duke ripare ne menyre te menjehershme kostot e ketij realiteti te ri, do te ndehyjme ne kontratat aktuale qe rregullojne kete sherbim, duke bere te mundur berjen efcient te ketij investimi shume te rendesishem dhe modern, per tu larguar njehere e mire nga realiteti i deri me tanishem.

Bashkia e Re Sarandë gjithashtu synon promovimin e riciklimit te mbetjeve urbane, ku si fillim mendohet te trajtohen letrat dhe metalet. Qellimi kryesor do te jete ndarja e mbetjeve qe ne burim nepermjet koshave te diferencuara.

**Pyetje 3: Saranda deri më sot nuk ka patur as plan strategjik dhe as plan zhvillimi të qendrueshem. Si do të veproni ju konkretisht per keto dimensione te munguara ?**

-Zhvillimi kaotik i territorit është nje nga plagët nga më të rënda, jo vetëm në Bashkinë Sarandë, por në të gjithë vendin, ka ardhur si rezultat i zhvillimit pa planifikim, zhvillim spontan, kaotik, i cili na ka sjellë në këtë situatë aspak të pëlqyeshme duke mos lejuar një zhvillim të qëndrueshëm dhe raporte të qarta në territor. Nga Bashkia aktuale janë nisur procedurat e planifikimit të territorit të cilat ndahen në tre faza:

- Miratimi i Dokumentit Strategjik
- Plani i Përgjithshëm Vendor
- Planet e Detajuara Vendore

Faza e parë, ajo e miratimit të dokumentit strategjik, ka përfunduar, ky dokument gjendet pranë institucionit të bashkisë dhe është sot për këdo një pikë e shkëlqyer referimi për zhvillimin e mëtejshëm të territorit, dhe jo vetëm. Në këtë dokument janë përcaktuar qartë skenarët e zhvillimit, vizioni, si dhe objektivat strategjik të zhvillimit të territorit.

Bashkia e Re do të nisë procedurat për përpilimin e Planit të Përgjithshëm Vendor që

(Vijon në fq. 3)

(Vijon nga fq. 2)

në muajin e parë të konstituimit të saj. Përmes këtij Plani do të synohet zhvillim i qëndrueshëm i territorit, duke siguruar shërbime publike dhe vendore cilësore, strehim dhe punësim. Ky zhvillim i ri i Territorit do të lehtësojë dukshëm transportin e mallrave dhe të udhëtarëve, do të ruajë, karakterin tradicional të zonave, dhe do të përmirësojë në mënyrë thelbësore cilësinë e jetës në bashki, do të ofrojë një jetesë të sigurt dhe tërheqëse. Përmes Policentrizmit, Bashkia e Re Sarandë, do të rrisë kohezionin territorial, dhe nëpërmjet krijimit të brezit të gjelbër, do të kufizojë shpërhapjen pa kriter dhe larg shërbimeve të domosdoshme të vendbanimeve duke rritur njëkohësisht kapacitetet e ambienteve çlodhëse publike dhe të gjelbra të territorit të bashkisë.

**Pyetje 4: Cilat do të jene prioritetet ne kurimin mjedisor te Sarandes si Bashki e re?**

-Motoja jone eshte Saranda blu dhe e gjelbert. Krijimi i hapsirave te reja publike, zgjerimi i lulishteve,


gjelberimi masiv duke filluar nga taracat e pallateve. Krijimi i brezit te gjelbert qe eshte nje nga pikat kryesore te programit, do te rrethoje gjithte zonat e urbanizuara te Bashkise Sarande.

Do te synojme gjithashtu krijimin e një rrjeti të fortë parqesh, duke nisur nga lulishte në nivel komuniteti ose lagjeje, parqe në nivel qyteti, parqe vendore, parqe rajonale dhe më pas ato kombëtare. Krijimi i sistemit të parqeve do të fuqizohet edhe me dhënien e roleve parqeve në nivele të ndryshme, ku disa mund të përdoren për rekreacion, disa të tjerë në formë fidanishtesh të hapura për publikun etj.

**Pyetja 5: Publiku tani ju njej nga programi, por jo stafin tuaj drejtues.** Dy fjale per kapacitetet menaxheriale te ketij stafi per te fituar kohen e humbur ne Sarande.

-Te gjithte e dime qe Saranda ka burime njerezore dhe kapacitete te mjaftueshme intelektuale, qe do te sherbejne ne bashkine e re. Ne do te

ftojme te gjithte qytetaret sarandiot te cilet njihen per kontributet e tyre ne fusha te ndryshme te behen pjese e vizionit tone te zhvillimit per Bashkine e Re Sarande. Projektet e sapo nisura ne bashkepunim me akademik te shquar si z. Besnik Aliaj, do te vihen ne jete pikerisht nga keta intelektuale qe kane kontribuar dhe do te vazhdojne te kontribuojne per Saranden.



Intervistoi Sh. HAJNO

## AJMMI - KRONIKA



Ing. Kristo Kauri duke udhëzuar nxënësit e Ksamilit për plotësimin e pyetësorit mjedisor të Grupimit "ECIM"



Drejtuesi i "REC" Shqipëri, Mihallaq Qirjo (në qendër), me anëtar të stafit të AJMMI-t në Sarandë.

## Bashkëpunim me qytetarët dhe ekspertët

### Qendra “Grupimi Ekolëvizja”



Nga Alisa PEÇI

Rrjeti ECIM, i drejtuar nga Ekolevizja ishte nje nder organizatoret e takimit qe u zhvillua dite e premte (dt.15.05.2015) midis kandidatit te Partise Demokratike per kryetar bashkie te Tiranës, z. Halim Kosova dhe eksperteve te mjedisit, pedagoqeve te Fakultetit te Shkencave te Natyres, shoqatave mjedisore, studenteve te Shkencave te Natyres dhe Inxhinierise se Mjedisit etj. Takimi konsistoi ne njohjen e ideve dhe programit te z. Kosova mbi zhvillimin e gjelber te qytetit te Tiranës dhe ne ngritjen e problematikave mjedisore nga te pranishmit.

Mjedisori Xhemal Mato shprehu shqetesimin mbi ndotjen e ajrit ne Tirane, qe e ka bere kete qytet e pajetueshem. “Tirana eshte

kthyer si nje kombinat i cili semur njerezit, ka humbje te energjise, njerezit paguajne 2 fishin e energjise ne krahasim me nje qytet normal, nuk ka jete te qete dhe te paster. Nga te gjithë treguesit Tirana eshte nje nder 5 qytetet me te ndotur te Evropës”- tha z. Mato. Ne kete kontekst ai pyeti z. Kosova mbi vizionin e tij per zhvillimin e gjelber te qytetit.

“Bashkepunimi me qytetaret dhe ekspertet do te jete mjaft e rendesishme ne punen si kryetar bashkie. Kontrolli sistematik, mbikqyrja e punes do te jete nje nga sekretet qe une do e transferoj nga sistemi shendetesor ne bashkine e Tiranës” - u shpreh ne takim z. Kosova. Gjithashtu matja e ndotjes ne menyre periodike do te jete nje element i rendesishem ne konstatimin e situates se cilesise se ajrit, per te ndermarre masat e nevojshme.

Ne lidhje me qendrimin mbi Parkun e Liqenit Artificial z. Kosova u shpreh: “Askush s’do e prek parkun dhe cdo lloj akti ligjor do zbatohet me perpikmeri ne mbrojtje te parkut”. Parku i Paskuqanit do te jete mushkeria e dyte e qytetit te Tiranës, bashke me liqenin Artificial te Tiranës. Do te mbillen fidane dhe drure dekorative, per te

pastruar ajrin.

Drejtuesi i EcoVolis Ened Mato tha ne takim se kur trajtojme ceshtjen e korsive per bicikle, nuk flasim thjesht per vijejime, por per vizionin e nje qyteti te tere qe i perket dyrrotakut. Ne lidhje me transportin e shendetshem me bicikleta z. Kosova u shpreh se bicikletat do te subvencionohen, qe njerezit te kene mundesi te kene bicikleten e tyre.

Eksperti i monitorimit te cilesise se ajrit ne Institutin e Shendetit Publik (ISHP), z. Agron Deliu kerkoi te kete nje laborator per matjen e cilesise se karburantit te makinave.

Eksperti i mjedisit, z. Gavrosh Zela sugjeroi te vendosen disa tregues per zhvillimin e qendrueshem, tregues qe te percaktohen me grupin e eksperteve dhe te raportohet mbi to. Ne lidhje me kete sugjerim z. Kosova u shpreh: “Parametrat do jene te percaktuara mire, do te kete shifra qe te jene te kontrollueshme dhe transparente per qytetaret. Bashkimi i forcave me qytetaret dhe ekspertet do beje qe sherbimi te jete sa me i shpejt dhe efikas”.

## Gjirokaster: Kanan Zanaj, emblemë e humanizmit



**Nga Mimoza LLAVDANITI**

Lavdia është një peshë e rëndë, një helm vdekjeprurës: ta durosh është një art . Dhe është e rrallë ta zotërosh atë lloj arti .Në ecejaket e ditëve të zakonshme ,në ato shëtitje në fillim mëngjesi ,ose buzëmbremje të zë syri një të moshuar ,dhe pse pesha e viteve që mbart mbi supe nuk të le kohë të mendosh se nuk mund ti ruaj ti gjitha kujtimet e jetës feminare dhe ato profesionale .Por nuk është e vërtet ,në memorien e tij duket sikur shfaqet një ditë I shkruajtur pastër dhe bukur ,pa gabime ortografike ,me shenja pikësimi të vendosura sipas rregullave të drejtëshkrimit .Portreti I Kanan Zanajt të bën të kujtosh të shkuarën ,të bën të vendosësh mbi këmbë të forta profesionin e infermierit ,nga I cili ke seç të përfitosh .

Në moshën 14 vjeçare pikërisht në vitin 1942 filloi punë në pavijonin e kirurgjisë së qytetit të Gjirokastrës ,pikërisht aty ku punonte kirurgu I famshëm Vasil Laboviti ,ose I quajtur ndryshe Vasili I Madh .Kjo ishte periudha më e madhe e shkollës së jetës ,përkrah njeriut me emër që bëri epokë në mjeksinë Gjirokastrite.Plot 46 vjet me një intesitet dhe përkushtim që rrallë individë I kanë .Kanan Zanaj ka qënë njeriu që ka asistuar në të gjitha operacionet dhe që ka kaluar në dorën e tij të gjithë të plagosurit që mbërrinin në Gjirokastër në vitet 1947-1949 gjatë luftës civile në Greqi.Në vitin 1947 kur greqia e porsadalë nga Lufta e Dytë Botërore ishte përfshirë nga një luftë akoma më e përgjakshme ,siç ishte dhe ajo civile. Përballë forcave shtetërore të drejtuara nga Napoleon Zerva ishin vendosur forcat partizane ,të cilat ishin po aq të organizuara dhe të përgatitura sa të parat.12 000 grekë të plagosur janë regjistruar në spitalin e Gjirokastrës gjatë luftës civile në Greqi ,10 mijë ndërhyrje kirurgjikale ,duke e detyruar në kë të mënyrë ekipin e kirurgjisë që të mos lëvizte nga salla e operacionit për të shpëtuar nga kthetrat e vdekjes djem që vinin radhazi në gjendje kome nga përtej kufirit . Ai ka qënë infermier I parë që ka asistuar në të gjitha operacionet dhe që ka kaluar në dorën e tij të gjithë të plagosurit që

mbërrinin në Gjirokastër ,gjithashtu ka qënë asistent I parë I kirurgut të famshëm Vasil Laboviti. Ai ishte një njeri që jetoi me profesionin ,krijoi dhe nuk konsumoi ,ai dinte të falte, nuk rrëmbente dinte të mbillte dashuri ,dhe jo urrejtje .Vetëm 19 vjeç dhe ishte në krye të pavijonit të kirurgjisë,nuk ishte e vështirë për të kuptuar situatën , por përgjegjësi jashtëzakonisht e madhe për të mbajtur mbi supet e brishta të një të riu që sapo e kish nisur rrugën e profesionit ,dhe pse pa ndonjë arsimim dhe përvojë të gjatë. Por kur dashuria për jetën dhe profesionin janë motivi dhe vizioni për të qënë shembull sacrifice ,kurdoherë arrin të kapërcësh vesh-tirësitë sado të vështira qofshin ato . Nuk ishte e lehtë përballja me situata dhe ngjarje të jashtëzakonshme në kohë të tilla ,sepse situatat vëshirësosheshin edhe më shumë nga kushtet e munguara në spital madje mungesa e dritave dhe ujit ishin prezente,por dhënia e ndihmës dhe operacionet nuk u ndërprejnë për asnjë moment . Simboli I njeriut human ,sakrificës ,dashurisë për të shpëtuar jetë, kanë qënë dhe mbeten në idealin e një profesionisti që sa herë nis bisedën për shëndetin ,të risjell në memorien e kohës sakrificat e një brezi ndonëse jo të formuar në auditore univeritetesh ,por formimi I tyre I kishte rrënjët tek dashuria .Ngarjet e vitit 1947 përbënin një sprovë të madhe gadishmërie dhe profesionalizmi .vazhdimi I dyndjeve I partizanëve grekë të plagosur drejt spitalit të Gjirokastrës ,e cila arrinte në 350 në numër përbënin sakrificën njerëzore ,por solidarizimi ishte një element që shifej qartë në sytë e gjithë banorëve ,dhe pse në kushte të mjerueshme ekonomike ,madje dhe pa ushqimet bazë nuk ngurronin të jepnin konrtibutin me se mundeshin .Kanan Zanaj ishte një ndër figurat më të spikatura krah Dr.Labovitit .Edhe në kushte tejet të vështira ,madje duke sakrifkuar dhe veten qëndrimi në sallën e operacionit I kalonte kufijtë e normales ,të përfshirë nga 10-orë dhe në raste të ngarkuara dhe 24 orë pandërpreje .Ai ishte një profesionist I aftë

jo vetëm si asistent ,por në momente të veçanta kur e kërkonte nevoja ,kryente edhe intervente kirurgjikale për ti shpëtuar jetën pacientit .Ai ishte një njeri humanitar jo vetëm duke vënë në dispozicion aftësitë e tij profesionale por duke konsumuar dhe kohën e tij në shërbim të pacientëve . Kanan Zanaj për detyrën e shenjtë që kishte zgjedhur në shërbim të ruajtjes së shëndetit ,për vetmohimin ,humanizmin devotshmërinë , në rritjen e kultures shëndetësore të popullit ,në marjane masave profilaktike për çrrenjosjen e shumë sëmundjeve infektivo -shoqërore në uljen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë ,padiskutim që ka mare mirnjohjen jo vetëm nga qytetarët e tij por dhe nga zonat përreth , ai është babai I shërbimit infermieror kirurgjikal ne qytetin e Gjirokastrës.

Kanan Zanaj njihet në historikun e spitalit të qytetit të gurtë të jugut si personi që në vitin 1955 ka krijuar për herë të parë pavijonin e grumbullimit të gjakut .Në atë periudhë në spital grumbulloheshin 500-600 kg gjak në vit.Ngajrje dhe një vlerë e padiskutueshme e Kananit ,që e niste ditën e punës me iden se ç,fare do të ndryshonte ,si do të përmirësohej cilësia e shërbimit . Cdo periudhë e moshës ka veçantinë e saj ,problemet ,ngjarjet dhe ndodhitë e saj ,ajo që ka rëndësi për këdo në jetë nuk është nga vjen ,por ka rëndësi ku shkon ,dhe cilido nga ne duhet jo vetëm të shohë të jetojë çdo gjë përreth ,por dhe ta riprodhojë ,ta dokumentojë të lerë gjurmët e vete në jetë.

## FOTO - KRONIKA



AJMMI organizoi së fundmi konkursin e piktorëve të shkollave ne Sarande me tematik: *“Unë e dua Saranden te gjelber”*. Aktiviteti u mbeshtet nga REC Shqiperi ne kuadër te projektit *“Ekosistemi i Komunikim - Informimit Mjedisor”*. Veprimtaria synoi nxitjen e sensibilizimt mjedisor në qytet përmes talenteve në pikturë të shkollave të qytetit.



## AROMË TRADITE



- Ka hyrë në vitin e dytë miniprojekti "AROME TRADITE Në BUTRINT" që zbatohet nga Agjencia "AJMMI". Projekti mbështetet nga organizata PPNEA (Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit natyror në Shqipëri) dhe Parku Kombëtar Butrint. Projekti i quajtur ndryshe "Nxitje e aktiviteteve të qëndrueshme që promovojnë produktet e tradicionale në hapësirën: Parku Kombëtar Butrint-Sarandë", synon njëherësh vetpunësim të një numri grash nëpërmjet prodhimit dhe shitjes në qytetin antik të produkteve kulinare të traditave multikrahinore kryesisht në qytezën e Ksamilit po edhe në fshatra të tjera në fqinjësi me qytetin antik të Butrintit. Turistët e Butrintit nga anë të ndryshme të globit, kanë shijuar larminë kulinare të prodhimeve të shtëpiakeve të papuna me origjinë nga disa krahina që bashkëjetojnë në një "MiniShqipëri" në Ksamil si: Camëria, Tepelena, Vlora, Minoriteti etnik grek, Kukësi, Korça, Përmeti, Saranda, etj.,



# AROMË TRADITE



## Të njohim, ruajmë e shfrytëzojmë bukurinë e natyrës

Nga Entela GJONI

Shoqata e gruas "JONA" ne Sarande po zbaton mini-projektin "Te njohim, ruajme e shfrytëzojme bukurine e natyres sone". Ky mini-projekt po synon rritjen e nivelit te edukimit mjedisor dhe ndergjegjesimin e nxenesve te shkollave per ruajtjen e biodiversitetit ne zonen e PKButrint .

Shoqata e Ruajtjes dhe e Mbrojtjes se Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) në partneritet me Shoqërinë Bullgare për Mbrojtjen e Shpendëve (BSPB) po zbatojnë projektin "Toka e Kështjellave dhe Shqiponjave: Një Model Pararojë për Turizmin e Qëndrueshëm në Bregdetin Shqiptar të Adriatikut". Ky projekt mbështetet financiarisht nga "Fondi i Partneritetit për Ekosistemet Kritike" (CEPF). Fondi i Partneritetit për Ekosistemet Kritike është një nismë e përbashkët e Agjensisë Franceze të Zhvillimit, Bashkimit Europian, "Fondit Botëror për Mjedisin", Qeverisë Japoneze, Fondacionit MacArthur si dhe Bankës Botërore.

Si pjesë e këtij projekti Shoqata "JONA" organizoi nje sere veprimtarish me nxenes te shkollave te P K Butrintit : Vrine, Mursi, Xarre, Cuke, Aliko dhe Ksamil me temen : "Te njohim,ruajme e shfrytëzojme

bukurine e natyres sone". "JONA" organizoi gjate muajit Prill- Maj, me nxenesit e shkollave te PK Butrintit nje sere veprimtarish informuese dhe sensibilizuese ne bashkepunim me DASarande dhe drejtorite e shkollave qe jane pjese e PKB : Mursi-Xarre, Vrine, Ksamil, Aliko-Cuke . Veprimtarite praktike per mirembajtjen e mjedisese brenda teritorit te shkollave , Biseda informuese per vlerat natyrore te kesaj zone ,ishin aktivitetet e para qe u zhvilluan ne keto shkolla. Ing, Kristo Kauri ,qe u be pjese e stafit te "JONA"s, me pasionin dhe njohurite e tij u foli nxenesve per natyren e pasur te Zones ,njohjen e vlerave te saj dhe si mund te kontribuojme e shfrytëzojme ato ne interes te shendetit dhe mireqenies sone. Nje aktivitet sensibilizues shume i bukur ishte ekspozita dhe konkursi qe u zhvillua midis shkollave te zones per te shtuar njohurite rreth PKB dhe ruajtjen e pasurive natyrore te zones

Aktiviteti qe filloi me grumbullimin e nxenesve rreth ores 9.30 ne amfiteatrin e Parkut te Butrintit dhe zgjati rreth tre ore. .Ne muret anesore te skenes se Amfiteatrit u vendosen punimet e nxenesve per ekspoziten si: postera me bime e kafshe te zones ,me vizatime e printime ,herbariume, edhe

makete te parkut Kombetar te Butrintit. Seicila shkolle paraqiti edhe ESSE -te e perzgjedhura , te pergatitura nga nxenesit. Juria e konkursit perbehej nga Inxh.Kristo Kaur , Znj. Eleni Guda inspektore mjedisi dhe mesuese biologjie, Znj. Neriman Gjivogli mesuese letersie dhe aktiviste e shoqates.

Konkursin e drejtoi znj. Pranvera Brinja , aktore dhe kengetare e Q.Kulturore Sarande, qe me diksionin e mrekullueshem te saj terhoqi vemendjen e te pranishmeve pjesemarres dhe ngjalli interesim edhe tek vizitoret e Parkut .Te gjitha shkollat ishin pergatitur mjaft mire ,dhe me shume interesim per kete aktivitet. Konkurrenca ishte e dukshme dhe diferenca per fituesin si gjate konkursit edhe ne finale ishte tek pyetja enigme. Shkolla e Cukes u shpall fituese e Konkursit.

Nje pergatitje shume te mire dhe larmi punimesh kishte shkolla e Ksamilit ,e cila zuri vendin e pare ne pergatitjen e posterit ,herbariumet dhe vizatimet me floren dhe faunen e zones. Pune interesante paraqiten edhe shkolla e Xarre-Mursise dhe ajo e Vrines, me postera,vizatime e herbariume per pasurite e natyres se vendlindjes .

(Vijon në fq. 12)



## Turizmi familjar, mundësi që duhet shfrytëzuar!

Turizmi është një ndër sektoret me perspektive të lartë zhvillimi në Shqipëri, fryt ky i elementeve të larmishëm turistike që gezon vendi ynë. Por pavaresisht këtij fakti, zhvillimi i tij vazhdon të mbetet i zbehtë dhe kaotik, duke shfaqur kështu mungesën e një vizioni dhe drejtimi të qartë.

Kerkesat për zhvillimin e turizmit janë të panumerta dhe komplekse, megjithatë ndër me baziket konsiderohen sigurimi i infrastruktures akomoduese dhe ushqimi që duhet t'u ofrojmë turistëve. Të dy keto shërbime në vetvete karakterizohen nga një larmi formash, si hotele (me numer të ndryshëm yjesh), shtëpi pushimi, kampingje etj. Në këtë drejtim, zonat me të dalluara turistike në vend janë mbushur me një mori ndërtimeve shumëkateshe, të cilat kanë zënë pothuajse të gjitha hapësirat e lejueshme të ndërtimeve dhe që sigurisht, i kanë tejkaluar. Është e lehtë të pohosh se një pjesë e mirë e këtyre zonave janë tejngopur me ndërtime, dhe me shume të tilla do të kercenonin seriozisht vlerat e tyre.

Kështu, gjendemi përballë një proporcioni jo të drejtë: nga njëra anë ekziston një mori ndërtimeve, por nga ana tjetër kapaciteti akomodues për turistët është i vogël.

A përben ky një ngrëç? Mendoj se është i tillë! Ashtu sikurse mendoj se ekziston edhe një zgjidhje që mund të jetë e pershtatshme dhe mjaft fitimprurëse: "Turizmi familjar" ose "Guest House Tourism" siç njihet ndërkombëtarisht.

Turizmi familjar po shnderrohet në një prej formave më të pelqyera për disa kategori turistesh që përbejnë një numer të madh në teresi. Në shume vende të botes është investuar në këtë drejtim dhe tashmë turizmi familjar përfaqëson burimin kryesor të punësimit dhe të të ardhurave për teresinë e familjeve që e praktikojnë. Edhe në Shqipëri, përgjate viteve të fundit ka filluar të praktikohet turizmi familjar në pak zona, si për shembull Voskopojë, Dardhë, Thethi etj., por

në shume fshatra të tjera si këto nuk mund të gjejmë qoftë edhe një shtëpi të vetme të turizmit familjar.

Gjate punës së vazhdueshme në terren vitet e fundit në të gjithë vendin, kryesisht në zonat me vlera të dalluara turistike e natyrore, kam krijuar bindjen se zhvillimi i turizmit familjar, është një prej mundësive më domethënëse për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe natyror të këtyre zonave.

Më një perkufizim të thjeshtë do të thosha se: "Turizmi familjar është ajo dege e turizmit, ku familjet e caktuara mikpresin turistët, duke ofruar akomodim dhe ushqim kundrejt pagesës".

Për sa i përket akomodimit, pas viteve '90, me liberalizimin e ndërtimeve, ndikimin e emigracionit në aspektin ekonomik dhe social, shume qytetare shqiptare kanë ndërtuar vila dhe shtëpi shumëkateshe, të bukura dhe komode në të cilat sipërfaqe të mëdha (shpeshherë me shume në një kat) nuk përdoren nga familjarët. Dhe këto ndërtime janë ndërtuar kryesisht në pozicion të larta piktoreske. Pra ekzistojnë shume njësi akomoduese me potencialistik. Për më tepër: nga një vëzhgim i kujdesshëm në disa zona turistike në vendin tonë, rezultoi se pothuajse 100% e zotëruesve të këtyre shtëpive janë dashamirë dhe të interesuar për praktikimin e këtij lloji turizmi.

Se dyti, zhvillimi i turizmit familjar krijon një treg të leverdishëm për produktet bujqësore dhe blegtorale, si dhe zbatimin e praktikave të qëndrueshme të prodhimit të tyre me qëllim prodhimin e produkteve organike, të parapëlqyera nga kategoria e turistëve që ndjek këtë lloj turizmi. Prodhimi i qëndrueshëm bujqësor ndër të tjera, në mënyrë të drejtperdrejtë siguron: mbrojtjen afatgjatë të mjedisit bujqësor dhe ujorë nga ndotja dhe degradimi, rritjen e vlerës së produkteve, si dhe indirekt përbush një prej direktivave europiane për uljen e përdorimit të produkteve fitosanitare në bujqësi. Më tej, zhvillimi i këtij lloji



Nga Mirjan TOPI

turizmi mund të ndikojë pozitivisht dhe në zhvillimin e sektoreve të tjera, si artizanati dhe agro-industria, duke krijuar treg për këto produkte.

Zhvillimi i turizmit familjar krijon strukturë akomoduese gjithëpërfshirëse të hapura dhe rrjedhimisht rrit mundësinë për zhvillimin e një turizmi gjithësezonal dhe zhvillimin e degeve të tjera, si atij kulturor, dimëror, sportiv, i cili mungon në vend, pasi fluksi i turistëve është kryesisht në muajt e verës dhe turistët janë kryesisht pushues.

Gjithashtu, kontakti i vazhdueshëm i familjeve me turistët e huaj, krijon një mjedis të shkëmbimeve dhe eksperiencave ndërkulturore çka ndikon në mënyrë të drejtperdrejtë në zhvillimin kulturor e edukativ të tyre dhe të gjithë vendit në përgjithësi. Në fund, turizmi familjar ka kosto relativisht shume herë më të ulët zhvillimi, nuk ka kosto oportune (pasi nuk na duhet të prishim hapësirë për ndërtime të turizmit masiv) dhe është relativisht i lehtë për t'u përhapur nepernjë projektëve pilot.

Përmbledhtazi do të theksoja se zhvillimi i turizmit familjar në vend përfaqëson një mundësi domethënëse për të siguruar një zinxhir përfitimesh afatgjatë si: rritja e vlerës së investimeve të deritanishme të qytetarëve në këto zona, gjenerimin e vendeve të qëndrueshme të punës, zhvillimin e metejshëm shoqëror të vendit, zbutjen e impakteve të industrisë së ndërtimeve, si dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore e turistike në teresi.

## FOTO VËZHGIM



**“Natyre e qetë”:  
Lopët e Bashkisë Sarandë, të çertifikuara,  
duke kullotur qetësisht në kazanët e mbeturinave urbane në qytetin turistik.**



(Vijon nga fq. 10)

## QASJE

### ***Të njohim, ruajmë e shfrytëzojmë bukurinë e natyrës***

ESSE -ja me e mire u paraqit nga nxenesja Megi Sedaraj nga Shkolla “5 Dëshmoret “Ksamil. Nderkohe nxenesit kishin përgatitur dhe recitime e pjese skenike qe shoqeruan aktivitetin. Fituesit moren certifikatat dhe cmimet e akorduara. E vecante ishte kureshtja e turisteve qe vizitonin Parkun ne ate kohe . Ata u ulen edhe ne shkallet e amfiteatrit duke duartrokatur bashke me ne dhe pane me kureshtje punimet e nxenesve te ekspozuara ne muret e amfiteatrit . Keto veprimtari te bukura treguan se duke siguruar nje bashkeveprim te mire te punes do te sigurojme edhe nje edukim dhe

reagim qytetar me te fuqishem per mbrojtjen e pasurive te natyres tone.



## Të pastrojmë bregdetin në një ditë

Nisma për të pastruar bregdetin në një ditë iu përgjigjën edhe shkollat 9-vjeçare. Nxënësit e shkollës "Adem Sheme", të informuar mbi këtë ditë dhe rëndësinë e pastrimit të bregdetit më 22 Maj si dita e Biodiversitetit pati një impakt të madh tek fëmijët për një fillim të mbarë të sezonit turistik, si dhe edukimin e vazhdueshëm mjedisor. Ata të pajisur me qeska dhe doreza u treguan të gatshëm për të kontribuar për pastrimin e bregdetit.



Pastrimi për disa orë nuk u dha fund problemeve të ndotjes, por rriti ndjenjën e përkushtimit tek të rinjtë për grumbullimin e mbetjeve që na shqetësojnë çdo ditë. Sigurisht që kjo ditë duhet të jetë e përditshme dhe e vazhdueshme për mjedisin ku ne jetojmë dhe punojmë. Përfytyrojmë për një cast sikur të gjithë njerëzit të respektonin mjedisin, sikur ta kuptonin se sa i rëndësishëm është ai në jetën e tyre e të kujdeseshin për të. Njeriu mund ta permirësojë ose ta përkeqësojë gjëndjen e mjedisit ekzistues, mund tja ndryshojë pamjen, mund ta lulëzojë ose ta shkatërojë atë.

Një globalist i shquar, në një samit ndërkombëtar, tha se: "ndotja e mjedisit është thjesht pas efekt i ndotjes së shpirtit". Dhe ka pasur të drejtë, sigurisht. Njeriu duhet të jetë i ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka mjedisi, për respektin që meriton, si dhe për kujdesin që

duhet të rritet vazhdimisht. Që i vogël duhet të edukohet, dhe të mësohet që jeta e tij është e lidhur ngushtë me mjedisin ku jeton.

Kështu, nxënësit të veshur dhe pajisur me doreza qeska dhe me shumë dashuri për punë vrapojnë që të grumbullojnë sa më shumë plehra.

Po ka dhe nga ata që këtë ditë e kthejnë edhe në vargje:

*Dora ime e vogël  
Dora ime e vogël*

*Po nis e po shkruan,  
Për plehrat e hedhura,  
Që rrugët mbuluan.  
Të mendojmë për jetën,  
Dhe plehrat ti pastrojmë  
Që ajër të pastër të thithim,  
Çdo sekondë që jetojmë.*

### TË SHPËTOJMË PLANETIN

*Ha një çokollatë,  
Dhe pse së kupton,  
Letrën hedh në kosh,  
Planetit e shpëton.  
Koshi, koshi, koshi,  
E shpëton planetin,  
Gjithë mbeturinat,  
E shpëtojnë planetin.  
Prandaj ti dëgjo,  
Rregullat zbato,  
Se po nuk dëgjove,  
Përveç të tjerëve,  
Dhe veten dëmtove*

Këto janë vargje janë të thjeshta, por mbartin çiltërsinë dhe pastërtinë e fëmijëve, të cilët do ta bëjnë këtë vend më të bukur dhe më të begatë.



**Msc. Vasilika KREKU**



## Premtimet e fushatës dhe leshtë....

Nga Ana Gjon LEKDUSHI

Tek dëgjoj premtimet në fushatën zgjedhore, mu kujtua një anekdotë.

Një qytetar i Tiranës, i kishte dhënë borxh disa lekë një mikut të tij nga fshati. Kaloi disa kohë dhe miku i tij nuk po bëhej i gjallë ti kthente borxhin. Ndaj qytetari vendosi të shkonte e ta kërkonte në fshat. Tek shtëpia e mikut të tij gjen gruan. Pasi e përshëndet e pyet:

- Ku e ke burrin?

- Po ja, për punën tënde ka vajtur në qytet! - i thotë ajo.

- Pse? - e pyet miku.

- Po ja!- i thotë gruaja. - Këtu tek shtëpia jone, kalojnë delet e fshatit dhe përplasen tek gardhi. Burri vajti të blente fare ferre. Do ta mbjellim, ferra do rritet, delet do kalojnë tek gardhi, do të përplasen dhe do lënë leshtë aty. Ne do ta mbledhim, do ta lajmë leshin, do t'a tjerrim, do ta shesim dhe do të të kthejmë borxhin ty!

Burri filloi të qeshte.

-Qesh ti qesh, se i sigurove paratë, por ne do të na bjerë bretku!- i tha gruaja.

## FOTO MEMORIE



Në Foto: Viti 1993.  
Skaut shqiptarë dhe grekë në Qendrën e Skautizmit në Janinë(Greqi)  
(AJMMI-Foto Arkiv.)

-Pas viteve të diktaturës për herë të parë në Shqipëri Skautizmi Shqiptar, pas një ndërprerje për shkak të Luftës së Dytë botërore dhe të regjimit komunist, rilindi në Sarandë në vitet 1991-1992. Saranda ishte edhe qendra kombëtare e Skautizmi shqiptar me Emrin “**BESA SKAUT ALBANIA**” për shumë vite. Skautizmi i ri shqiptar u krijua nga çifti i mësuesve të pasionuar sarandiotë **Doloreza Alipirgu Dhima** e **Mihal Dhima**. Me sloganin “**SHUMË VENDE-NJË BOTË**”, me frymën e parimeve të vëllazërimit ndërkombëtar rinor; u edukuan ndër vite qindra të rinj sarandiotë e mijëra të tjerë nga rajone të ndryshme të Shqipërisë. **Shqipëria është anëtarë e WOZMI-t, org.botërore e skautizmit.**

## Të mëshironi një komb...



Nga Khalil GIBRAN

Të meshironi një komb me turma plot dogma dhe besime boshe. Të meshironi një komb, që vesh rroba që nuk i përgatit vete, që ha


bukën që nuk e korr vete, që pi verë jo të shkelur vete. Të meshironi një komb që mburr edhe lavderon një njeri që përdor dhunën dhe konsideron bujar pushtuesin e bujshëm. Të meshirosh një komb që përçmon pasionin në endrrat e tij dhe kur zgjohet në mëngëz kërkon meshirë. Të meshirosh një komb, që nuk ngre zërin veç në procesione funerale dhe fryhet si gjel veten mbi rrenojat e tij dhe nuk revoltohet, vetëm atëherë kur gryka e tij gjendet midis sopesës dhe trungut. Të meshirosh një komb që ka politikan një dhelpër, që ka për filozof të tij një xhonger dhe art i tij është art i arnimit dhe i imitimit. Të meshironi një komb që mirepret qeveritarin e ri me brohoritje dhe e përcjell atë me klithma përçmimi deri sa të pres të riun, me brohoritje dhe prap nga e

para. Të meshironi kombin që dijetaret e tij heshten me vite dhe burrat e tij të fortë janë akoma të mitur. Të meshironi kombin që u bë copa dhe çdo pjesë e tij e deklaroi veten komb”



Perktheu: Vasilika IFANDI

### KARIKATURA E NUMRIT



Enderr apo Realitet ?????!!!... Partia dhe zgjedhësit (miniature)

**PROGONATI**  
**SH.P.K**



**SARANDE**

**Artur Qendro**  
Administrator

Phone: 0852 2 61 -52  
Magazine: 069 55 90 893  
Cel: 069 20 94 036  
069 43 15 314

E-mail: [progonatishpk@yahoo.com](mailto:progonatishpk@yahoo.com)

DISTRIBUTOR



**Mobileri**  
**Fetani**



**AT E BIR. ARTUR E ALEKSANDER QENDRO, MIQ TE MJEDISIT (Foto: SH.H-AJMMI)**